



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.02.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **T-Consulting d.o.o. Sarajevo**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi **206-23-13309-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si e jashtë afatshme ankesa e OE ankues **T-Consulting d.o.o. Sarajevo**, e datës 20.02.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH"** me nr. prokurimi **206-23-13309-1-1-1**, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Mbetet ne fuqi, Njoftimi për Kontratë i datës 30.11.2023 dhe sqarimet shtesë ne procedurë;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik T-Consulting d.o.o. Sarajevo, me datën 20.02.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim e cila është e jashataftshme per tu trajtuar.

Afati i fundit per dorezim te kerkeses per rishqyrtim ka qene deri me 09.02.2024 ora 16:00, ku jane parashtruar dy kerkesat paraprake per Rishqyrtim nga OE Cactus dhe OE Vepro AG, te cilat jane shqyrtuar dhe është shtyre afati per ofertim deri me daten 26.02.2024 ora 14:00.

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit pubik

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit

të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Kronologjia

Autoriteti Kontraktues, ka shpallur aktivitetin e prokurimit me date 30.11.2023.

Afati i fundit për dorëzim të tendereve ishte 01.02.2024.

Me date 30.01.2024 është bërë korigjimi dhe shtyrja e afatit për ofertim për datën 15.02.2024.

Me date 09.02.2024 janë parashtruar dy kërkesa për rishqyrtim, të cilat janë trajtuar me datën 14.02.2024 dhe është bërë shtyrja e afatit për ofertim për datën 26.02.2024.

Ne përputhje me nenin 63.1.1 (b), i cili nen përcakton "Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit" Ministria e Shëndetësisë me date 13.02.2024, ka publikuar Njoftimin mbi Korigjimin e procedurës dhe ka shtyrë afatin e dorëzimit deri me date 26.02.2024.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e juaj është dorëzuar me date 20.02.2024.

Ne përputhje me nenin 60.1. (a), kërkesa e juaj për rishqyrtim është dorëzuar jashtë afatit kohor sepse afati prej se paku 5 ditëve *nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. OE T-Consulting d.o.o. Sarajevo
3. Operatorëve ekonomik të interesuar.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit